

Breaking News:

DVP Berat/Kapet në Berat, 1 shtetas i shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentativë





Lajmet

Operacionet

26/08/2026

Tiranë/Finalizohet Operacioni I Koduar “Price”

Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar “Price”. Goditet një tjetër tentativë për të shitur armë zjarri.

Lëvizte nga Kruja në Tiranë, për të shitur një pistoletë, arrestohet 26-vjeçari.

Sekuestrohet arma, automjeti me të cilin lëvizte i arrestuari dhe celulari i tij.

Shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqueve, si rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacionit të siguruar në rrugë operative, për një shtetas që po levizte drejt Tiranës, me armë zjarri, në automjet, finalizuan operacionin e koduar “Price”, gjatë të cilit u arrestua te vendi i quajtur “Kthesa e Kamzës”, shtetasi N. D., 26 vjeç, banues në Krujë.

Nga kontrolli në automjetin që drejtonte 26-vjeçari u gjet 1 armë zjarri (pistoletë) që dyshohet se ishte siguruar dhe po transportohej me qëllim shitjen në Tiranë.

Vijon hetimi për identifikimin dhe ndalimin e shtetasve të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë rast kriminal, si dhe për dokumentimin ligjor të të gjitha rrethanave të tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar “Price”

Policia e Shtetit





Watch on

◀ Bulqizë/Finalizohet operacioni i koduar “Indicia”, goditet një rast i kultivimit të bimëve narkotike

DVP Berat/Kapet në Berat, 1 shtetas i shpallur në kërkim për vrasje të mbetur në tentativë ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

>

Arkiva

>

Akademia e Sigurisë

>

Ministria e Brendshme

>

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

>

Interpol

>

Europol

>

Misioni PAMECA V

>

SCPA

>

Projekti Trivalent